



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

BORDI

VENDIM

Nr. 32, Datë 27.03.2024

MBI

**KËRKESËN E SHOQËRISË “DRINI BULQIZE” SH.P.K. PËR LICENCIM NË  
VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të nenit 16 ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 14, pika 10 të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar; si dhe nenit 15 dhe të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 27.03.2024, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 130/18prot., datë 26.03.2024, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes “Mbi kërkesën e shoqërisë “DRINI BULQIZE” sh.p.k.. për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike”,

**Konstatoi se:**

- Shoqëria “DRINI BULQIZE” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 2417 prot., datë 17.11.2023, paraqiti kërkesën për pajisje me licencë për prodhimin e energjisë elektrike dhe bordi i ERE-s me vendimin nr. 354, datë 01.12.2023, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Polemi”.
- ERE botoi njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure (në datat 02.12.2023 dhe 04.12.2023) dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët (data 11.12.2023), nuk rezultoi të ketë të tilla. Ky njoftim u botua dhe në faqen zyrtare të internetit të ERE-s.
- Pas korrespondencës së zhvilluar me shoqërinë, nisur nga nevoja për të pasur kohën e mjaftueshme për shqyrtimin e dokumentacionit shtesë të depozituar nga ana e saj dhe/ose shkëmbimin e një korespondence të mëtejshme me shoqërinë, bordi i ERE-s me vendimin nr. 381, datë 28.12.2023 vendosi të zgjasë deri në 30 (tridhjetë) ditë afatin për marrjen e vendimit përfundimtar për aplikimin e shoqërisë.
- Pas shqyrtimit të dokumentacionit shtesë të depozituar nga shoqëria, ka rezultuar se mbetet ende dokumentacion i paplotësuar dhe po ashtu ka lindur nevoja që vetë ERE t’i drejtohet me kërkesë për informacion Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), Agjencisë Kombëtare të Mjedisit (AKM) dhe Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore (AMBU).
- Në këtë rrethana, me vendimin e bordit të ERE-s nr. 11, datë 29.01.2024, u vendos zgjatja me 30 (tridhjetë) ditë pune e vendimmarrjes përfundimtare e bordit të ERE-s në lidhje me

kërkesën e shoqërisë “DRINI BULQIZE” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike. ERE me shkresën nr. 130/8 prot., datë 05.02.2024, ka njoftuar shoqërinë për vendimin e bordit nr. 11/2024, duke i evidentuar dhe dokumentacionin që mbetej ende pa plotësuar nga ana e saj.

- ERE me shkresën nr. 130/7 prot., datë 05.02.2024, iu drejtuar AMBU-së, në lidhje me statusin e rinovimit të lejes së përdorimit të burimit ujqor dhe AMBU në përgjigje, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 130/12 prot., datë 09.02.2024, ka informuar se “DRINI BULQIZE” sh.p.k. ka aplikuar për rinovimin e lejes së përdorimit të burimit ujqor dhe aktualisht ky aplikim është në fazën e trajtimit nga strukturat përkatëse në AMBU. Në këto rrethana rezulton se “DRINI BULQIZE” sh.p.k. nuk disponon aktualisht një leje të vlefshme për përdorimin e burimit ujqor për prodhim hidronergjie nga HEC “Polemi”, por është në proces rinovimi të kësaj lejeje.
- Me shkresën nr. 130/9 prot., datë 05.02.2024, ERE i është drejtuar Agjencisë Kombëtare të Mjedisit në lidhje me vlefshmërinë e VNM-së paraprake dhe AKM me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 130/14 prot., datë 16.02.2024 ka informuar ERE-n se nga verifikimi i bazës së të dhënave rezulton se ka dorëzuar raport monitorimi për periudhën Korrik 2019-Janar 2020... Subjekti “Drini Bulqizë” është inspektuar në datën 19/08/2019 dhe nuk rezulton të ketë shkelje të kërkesave ligjore. Deklarata mjedisore apo vendimi për VNM paraprake për projektin e propozuar është e vlefshme për aq kohë sa është i vlefshëm dhe dokumenti i miratimit të zhvillimit përkatës për projektin. Për sa informuar nga AKM e duke qenë se HEC-i është ndërtuar tashmë, rezulton se shoqëria nuk ka shkelur kërkesat ligjore të VNM-së Paraprake.
- Me shkresën nr. 130/10 prot., datë 05.02.2024, ERE i është drejtuar MIE-s me kërkesën për informacion/qëndrim, në lidhje me ndryshimet përkatëse në vlerën e investimit dhe kohën e ndërtimit të HEC “Polemit”, në referencë të përcaktimeve të Kontratës me nr. 119 Rep., nr. 61/1 Kol., datë 24.01.2018, ashtu si dhe për sa përcaktuar në raportin e AKBN-së, mbi testimin e kryer më datë 11.01.2024.
- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 130/17 prot., datë 20.03.2024, MIE ka vënë në dijeni ERE-n mbi shkresën drejtuar shoqërisë “DRINI BULQIZË” sh.p.k., ku në kuadër të monitorimit të kontratës për ndërtimin dhe shfrytëzimin e HEC “Polemi”, bën me dije se AKBN, me shkresat e datës 15.02.2024, dhe 25.02.2024 dhe ka informuar MIE-n mbi gjendjen aktuale të hidrocentralit “Polemi” dhe mbi mospërmbushjen e detyrimeve kontraktuale nga ana e shoqërisë. Në përfundim, referuar këtyre shkresave, MIE ka kërkuar nga ana e shoqërisë përgjigjen me argumentet bindëse. Për sa përcaktuar në këtë shkresë, vlerësohet që ERE, përpara se të marrë një vendim përfundimtar në lidhje me licencimin e shoqërisë “DRINI BULQIZE” SHPK, duhet të presë që MIE të dalë me një qëndrimin përfundimtar në lidhje me mos përmbushjen e detyrimeve kontraktore apo vlefshmërinë e kontratës nr. 119 Rep., nr. 61/1 Kol., datë 24.01.2018.
- Shoqëria në zbatim të përcaktimeve të nenit 9, pikës 1.3, gërmës “a” të Rregullores, ka depozituar në ERE shkresën e datës 27.02.2024, të Drejtorisë Rajonale Tatimore Dibër, drejtuar subjektit “DRINI BULQIZE” sh.p.k., në të cilën përcaktohet se, në përgjigje të kërkesës së datës 26.02.2024 të bërë nga shoqëria mbi gjendjen e detyrimeve të saj, subjekti Drini BULQIZE sh.p.k. nuk ka detyrime tatimore për llojin e tatimit të kërkuar nga ana Juaj.

Për sa më sipër konstatojmë se kjo shkresë është depozituar në ERE vetëm në format elektronik dhe nuk rezulton që të jetë depozituar kërkesa që vetë shoqëria i ka drejtuar organit tatimor, për të kuptuar nëse në objektin e saj janë përfshirë dhe detyrimet ndaj organeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, ndaj kjo pikë e Rregullores nuk është plotësuar tërësisht nga shoqëria.

- Në nenin 66, pika 1, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë” parashikohet se: nëse *organi publik që zhvillon procedurën përballet me një çështje, zgjidhja e së cilës është parakusht për zgjidhjen e procedurës dhe që përbën një çështje ligjore të pavarur, për zgjidhjen e së cilës është kompetent një gjykatë ose organ tjetër (“çështja paraprake”), organi publik që zhvillon procedurën administrative pezullon procedurën deri në marrjen e një vendimi të formës së prerë për çështjen paraprake dhe njofton palën në lidhje me këtë.*
- Po ashtu, në nenin 14, pika 10, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar, parashikohet se: *Bordi i ERE-s, rast pas rasti, pas fillimit të procedurës, mund të vendosë të pezullojë vendimmarrjen e tij.*
- Për sa parashikuar nga KPA dhe Rregullorja, duke qenë se leja e përdorimit të burimit ujor për prodhimin e energjisë elektrike dhe qëndrimi/miratimi përkatës i MIE-s në kuadër të vlefshmërisë së kontratës së nënshkruar me shoqërinë “DRINI BULQIZE” sh.p.k., përbëjnë dokumente thelbësore të kësaj procedure, vlerësohet të pezullohet vendimmarrja e bordit për kërkesën e shoqërisë “DRINI BULQIZE” sh.p.k. për t’u licencuar në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, deri në depozitimin në ERE të: lejes së rinovuar të përdorimit të burimit ujor, qëndrimin përfundimtar të MIE-s në lidhje me vlefshmërinë e kontratës nr.119 Rep 61/1 Kol., datë 24.01.2018, “Për sdërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e HEC “Polemi” me kapacitet prodhues 1.751MW”, shkresën e DRT Dibër në format origjinal/fotokopje e njësuar me origjinalin, si dhe vërtetimin që shoqëria nuk ka detyrime të pashlyera ndaj organeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

#### **Vendosi:**

1. Të pezullojë vendimmarrjen e bordit të ERE-s mbi kërkesën e shoqërisë “DRINI BULQIZE” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Polemi” deri kur të depozitohet në ERE:
  - a) *Leja e rinovuar e përdorimit të burimit ujor për prodhim energjie nga HEC “Polemi”.*
  - b) *Qëndrimi përfundimtar i Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë në lidhje me vlefshmërinë e kontratës nr.119 Rep 61/1 Kol., datë 24.01.2018, “Për Ndërtimin, Shfrytëzimin dhe Administrimin e HEC “Polemi” me kapacitet prodhues 1.751MW”.*
  - c) *Shkresa e Drejtorisë Rajonale Tatimore Dibër, datë 27.02.2024, në format origjinal ose fotokopje të njësuar me origjinalin.*
  - d) *Vërtetimi që shoqëria “DRINI BULQIZE” sh.p.k. nuk ka detyrime të pashlyera ndaj organeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore.*

2. Ky vendim është objekt rishikimi në kuadër të depozitimit të secilit prej dokumenteve të përcaktuara në pikën 1.
3. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë shoqërinë “DRINI BULQIZE” sh.p.k. për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARE NE DETYRE**

**Erjola SADUSHI**